



Prania / Presence Duhet / Required Presence / Delivery	30.04.2021	1	viii god Year
Organ / Organi City / Qytet	SKIMSHICK	2162/2021	115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 175/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 175/2021, të datës 23.03.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga: Rruga "C", BS-Group, HB-Nr.32, Komuna e Prishtinës, kundër Ministrisë së Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë, në çështjen juridike " transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

I.Obligohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që në afat prej 15 ditëve nga pranimi i këtij vendimi të shqyrtojë kërkesën e datës 03.02.2021 të parashtruar nga ankuesi dhe të nxjerr akt administrativ, konform dispozitave ligjore përkatëse.

II.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 23.03.2021, me numër protokolli 1319/2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për mos realizimin e kërkesës për transferimin e përhershëm për arsye shëndetësore pasi që institucioni ka krijuar heshtje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 29.03.2021, me numër protokoll 1435/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa me datën 30.03.2021 me numër protokoll 11483/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 23.03.2021 me numër protokoll 1319/2021 parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 05.03.2021 dërguar nga _____ për _____ Ftesa për takim e dërguar nga DZMP për _____ përmes e-maili të datës 05.03.2021 me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; Kërkesa për transferim e datës 03.02.2021 e dërguar përmes e-maili nga _____ për _____ Formularin e datës 01.02.2021 për shqyrtimin e kërkesave të nëpunësve për shkak të paaftësisë fizike apo mendore ose shëndetësore nga Divizioni i Komisioneve Mjekësore; Raportin Specialistik të datës 15.10.2020 me numër:4689; Emailin e datës 19.10.2020 dërguar nga _____ për _____ E-maili i datës 16.10.2020 dërguar nga _____ për _____ E-maili i datës 15.10.2020 dërguar nga ankuesi për Sekretaren e Përgjithshme _____ E-maili i datës 19.10.2020 dërguara për _____ Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 29.03.2021; përgjigja në kërkesë e datës 30.03.2021 me numër protokoll:1482/2021; Akt Emërimit e ankuesit të datës 04.09.2017; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar i Logjistikës "; Kërkesën e ankuesit e datës 19.10.2020 për transfer; E-maili i datës 15.10.2020; E-mailin e datës 21.10.2020 dërguar nga _____ për _____ E-mailin e datës 05.03.2021 dërguar nga _____ për _____ me korrespondencën e bashkangjitur prej 6 (gjashtë) faqesh.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar që ekziston baza ligjore për të vendosur, duke obliguar Departamentin e Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë/MPB që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme, për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me kërkesën e datës 03.02.2021 për transferimin e ankuesit

SEPSE:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi _____ në bazë të Akt emërimit të datës 04.09.2017 mbanë pozitë "Zyrtar i Logjistikës" në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa me datë 15.10.2020 i njëjti ka kërkuar nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Industrisë që t'i mundësohet transferi i përhershëm për shkak të problemeve shëndetësore, kërkesë kjo që më pas nga ana e Sekretares së Përgjithshme është përcjellë tek Udhëheqësja e Divizionit të Burime Njerëzore e cila të njëjtën kërkesë me datë 19.10.2020 e ka bërë tek Departamenti i Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë për transferimin e përhershëm të ankuesit në pozitën e "Inspektorit të Tregut", ndërsa Departamenti i Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë përmes e-mailit të datës 21.10.2020 i kanë kthyer përgjigje me kërkesën se ankuesi duhet të këtë paraprakisht vërtetimin mjekësor nga organi kompetent-Komisioni mjekësor për përcaktimin e shkallës së paaftësisë shëndetësore në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, po ashtu me rekomandimin se duhet pasur parasysh që pozita e "Inspektorit të Tregut" kërkon që zyrtari në fjalë të jetë kohë të gjatë në teren dhe ecje në këmbë në distanca të ndryshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesi me datë 01.02.2021 ka siguruar raportin nga Komisioni mjekësor për përcaktimin e shkallës së paaftësisë shëndetësore në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me të cilin nuk është evidentuar se ankuesit i është caktuar ndonjë lloj i paaftësisë së përhershme veçse është dhënë rekomandim për transferim/ricaktim në ndonjë vend tjetër të punës brenda institucioneve të shërbimit civil me specifikacionin se: *"në bazë të dokumentacionit mjekësor punëtori duhet t'i shmanget bartjes së peshave të rënda"*, dhe më pas me datë 03.02.2021 Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore e ka përsëritur kërkesën tek Departamenti i Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë për transferim të përhershëm të ankuesit për shkak të problemeve shëndetësore, ndërsa Departamenti Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë përmes e-mailit të datës 05.03.2021 i ka ftuar në takim për datën 08.03.2021 dhe nuk ka nxjerr vendim sipas kërkesës së parashtruar, andaj Ankuesi për shkak të heshtjes së Departamentit të Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë/MPB dhe mos nxjerrjes së vendimit apo dhënies së ndonjë informate as pas datës 08.03.2021, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil me datë 23.03.2021.

Ndërlidhur me kërkesën për transferimin e përhershëm të ankuesit Kolegji konstaton se kërkesa e ankuesit i është referuar nenit 53, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1, të Ligjit nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"1. Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: 1.1. të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme"*, si dhe nenit 10, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1, të Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: *"Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil në rastet: 1.1. e paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme"* mbi bazë të kësaj kolegji konstaton se ankuesi ka parashtruar kërkesën për transferimin e përhershëm për arsye shëndetësore, duke u bazuar në dokumentin mjekësorë të lëshuar me datë 01.02.2021, nga Divizioni i Komisionit Mjekësor i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi që ka shqyrtuar ankesën e ankuesit, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit sa i përket ndërrimit të punës për arsye shëndetësore, janë të bazuar në nenin 18 paragrafi 1 të Ligji nr. 06/1 - 114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *"Çdo institucion siguron një ambient të sigurt e të përshtatshëm pune për mbrojtjen e integritetit fizik, moral dhe të dinjitetit të zyrtarit"*.

Duke u bazuar në kërkesën e datës 03.02.2021 përmes e-mailit të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore, dërguar tek Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me transferimin e përhershëm për ankuesin sipas rekomandimeve të Komisionit Mjekësor të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Socialë, Kolegji për shqyrtim dhe vendosjen e ankesave konstaton se ky veprim është bërë në pajtim me nenin 11, paragrafi 1, të Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: *"Udhëheqësi i drejtpërdrejt i nëpunësit civil ose vetë nëpunësi civil mund të kërkojë transferimin në një pozitë tjetër të së njëjtës kategori ku është i aftë të kryejë detyrat. Kërkesa me shkrim duhet të jetë e arsyetuar dhe të njëjtës i bashkëngjitet vërtetimi i gjendjes shëndetësore nga organi kompetent mjekësor i siguruar sipas legjislacionit në fuqi dhe e njëjta i drejtohet njësisë përgjegjëse. Nëpunësi civil dëgjohet nga njësi përgjegjëse përpara se të marrë vendim dhe i paraqet asaj vërtetimin e gjendjes shëndetësore"*.

Kolegji për shqyrtim dhe vendosjen e ankesave konstaton se Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik (DZP), pas kërkesës së parashtruar nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Tregtisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë dhe për transferimin përhershëm të ankuesit, ka qenë i obliguar që të nxjerr vendim dhe të veprojë në pajtim me nenin 11, paragrafi 2 të Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, ku përcaktohet se: *"Për institucionet e administratës shtetërore, DMZP merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ose nëpunësi civil dhe vendos për transferimin në një nga këto institucione: " 2.1. në një pozicion tjetër të njëjtë institucion ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në një Agjenci Ekzekutive të institucionit ku është emëruar dhe degët lokale të saj; 2.3. në një institucion tjetër të administratës shtetërore".*

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se pas pranimit të vendimit të Këshillit, Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik (DMZP), është i obliguar që ta shqyrtojë kërkesën e datës 03.02.2021 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore për transferimin e ankuesit, të nxjerr vendim dhe në rast të aprovimit të kërkesës të veproje në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, duke pasur parasysh që pozita aktuale e ankuesit "Zyrtar i Logjistikës" si dhe pozita "Inspektor i Tregu" e propozuar për transfer nga institucioni hyjnë në kategorinë profesionale, mirëpo kategoria profesionale e shërbyesve civil, pastaj ndahet në klasa sipas dispozitave të Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, neni 13 i cili përcakton se: *"Klasat përbërëse të kategorisë Profesionale, dhe emërtesat e lejuara për secilën klasë janë: Profesional 1 -Zyrtar i lartë; Profesional 2 - Zyrtar i mesëm; Profesional 3 -Zyrtar; Profesional 4- Zyrtar Administrativ"* dhe po ashtu neni 16 Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil përcakton se: *"Karakteristikat e klasës, janë një përshkrim i përmblendhur i tipareve të secilit faktor klasifikimi për atë klasë që bën dallimin e saj me klasat e tjera dhe që përcakton peshën e klasës në klasifikimin e përgjithshme"* si dhe neni 18 dhe 21 i të njëjtës rregullore përcakton se: *"18. Kërkesat e përgjithshme formale janë kërkesat për zotërimin e arsimit që përfshin nivelin dhe fushën e arsimit, kualifikimin apo certifikimin e posaçëm që kërkohet për atë pozitë përkatëse; 21. Klasifikimi i një pozite konkrete të kategorisë profesionale si pjesë e një prej klasave të parashikuara në nenin 13 të kësaj Rregulloreje, bëhet nëpërmjet analizës dhe vlerësimit të nivelit të faktorëve të klasifikimit dhe të kërkesave të përgjithshme formale të kërkuara."*, e që sipas shtojcës Nr.1 të Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, karakteristikat sipas faktorëve të klasifikimit dhe kërkesat e përgjithshme formale nuk janë ekuivalente apo të ngjashme për katër (katër) klasat brenda kategorisë profesionale.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *"Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës"*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *"Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit"*.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.




Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.175/2021, datë 30/04/2021

Flakron Gashi



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Sekretarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Tregtisë, Industrisë dhe Ndërmarrësisë;
- Arkivit të KPMSHCK-së,